



Thirrje për Aplikim

Thirrje për aplikim për të rinj aktivistë me synim përfshirjen në qeverisjen vendore

Organizata Rinore SOEK-in në bashkëpunim me Bashkinë Librazhd Shqipëri, do të zbatojë këtë projekt me titull: **“Krijimi i përfaqësuesit të rinjve në proceset e vendimarrjes së qeverisjes vendore”**. Ky projekt zhvillohet në kuadër të Programit Rajonal për Demokraci Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë.

Në kuadër të këtij projekti SOEK-IN bën thirrje për aplikime nga të rinj të qytetit të Librazhdit me qëllim përfshirjen e tyre në qeverisjen vendore.

Përmes këtij propozimi ne synojmë që të ngrejme Këshillin Bashkiak Rinor, në kuadër të të cilit do të përzgjedhim një grupim heterogjen të rinjsh që u përkasin grupmoshës 17-29 vjeç. Në këtë thirrje synojmë përzgjedhjen e të rinjve të cilët janë me banim në qytetin e Librazhdit dhe t’i përkasin moshës 22-29 vjeç.

Të rinjtë e përfshirë do të jenë pjesë e aktiviteteve të parashikuara nga Projekti. Ndër të tjera:

1. Sesione trajnimi dhe Informimi me të rinjtë në lidhje me tematika të ndryshme
2. Pjesëmarrje në takimet me përfaqësuesit e Bashkisë.
3. Pjesëmarrje në Vizitat Studimore në Lezhë dhe Tiranë.

Gjatë një periudhe prej 8 muajsh me organizimin e trajnimeve dhe takimeve një herë në 2-javë. Të gjitha shpenzimet e pjesëmarrjes do të mbulohej nga projekti.

Kriteret për aplikim:

- Moshë 22-29 vjeç dhe të jenë me banim në qytetin e Librazhdit.
- Të dëshmojnë vullnetin dhe eksperiencën personale për të qenë aktivë në aktivitetet e projektit
- Të jenë të komunikueshëm dhe të hapur për të punuar në komunitet.

Për të kontaktuar ju lutem dergoni CV-në tuaj në adresën info@soekin.org. Afati i dorëzimit të aplikimit është data **6 Korrik 2019**. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen me e-mail. Për çdo pyetje ju lutem na kontaktoni në adresën info@soekin.org



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.